



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:276929

Datë: 31.03.2023

Numri i dokumentit: 04145589

2022:276930

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues

Imri Sejda, me procesmbajtësen Edona Salihu, në çështjen penale kundër të pandehurit N.M.K. nga fsh Ferizaj, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me Nd.nr...../23, të datës 03.03.2023, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit N.M.K. nga fsh..... Ferizaj, në njërën anë dhe të dëmtuarve E.Sh. nga Ferizaj dhe G.B. nga Ferizaj në anën tjetër, sipas aktakuzës së PP/II.nr.1898/22, të datës 21.12.2022, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së, në mbështetje të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datën 29.3.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja Nd.nr.... /23, të datës 03.03.2023, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit N.M.K. nga fsh..... K. Ferizaj, në njërën anë dhe të dëmtuarve E.Sh. nga Ferizaj rr. “.....” dhe G.B. nga Ferizaj rr. “.....” nr....., në anën tjetër.

Hudhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1898/22, të datës 21.12.2022 dhe PUSHON procedura penale kundër të pandehurit të lartcekur, për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1898/22, të datës 21.12.2022 të pandehurin e ka akuzuar, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Me dakordimin e palëve në shqyrtimin fillestar me dt.01.03.2023, konform nenit 4 dhe 8 të Ligjit për ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim.

Me datën 03.03.2023 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, është arritur marrëveshja Nd.nr...../23 në mes palëve në procedurë.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovojë këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësuar se është lidhë me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim me ligjin për ndërmjetësim në fuqi.

Konform nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim më datën 29.3.2023, aprovohet nga gjykata marrëveshja për ndërmjetësim dhe e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Konform nenit 453 par.1 të KPK-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 248 par. 1 pika 1.4 të KPPK lidhur me nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI

I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL

2022:276930, me dt.29.3.2023

Procesmbajtëse

Edona Salihu

Gjyqtari i vetëm gjykues

Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3/tre/ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.